



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut**

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 11.12.2013, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Vasilika Hysi – kryetare e nënkomisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Mbledhje njohëse me anëtarët e nënkomisionit.

**Marrin pjesë:**

Vasilika Hysi, Arben Ristan, Ermonela Felaj, Luna Duzha dhe Kastriot Islami.

## HAPET MBLEDHJA

**Vasilika Hysi** – Përshëndetje!

Sot organizojmë mbledhjen e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut. Tri javë më parë Kuvendi i Shqipërisë miratoi përbërjen e këtij Nënkomisioni. Ju kujtoj se Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Jemi të pesë të pranishëm. Kjo është mbledhja e parë e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut dhe së bashku me Arbenin kemi menduar të bëjmë një vizitë në burgun e grave në Tiranë. Kjo është vizita e parë monitoruese, në të cilën ne kemi ftuar edhe Aleancën e Grave Deputete për t'u bashkuar me Nënkomisionin tonë, por, para se ne të ndërmarrim këtë mision në terren, do të doja t'ju sillja në vëmendjen tuaj se Nënkomisioni është ngarkuar nga Kuvendi i Shqipërisë të hartojë planin e veprimit për zbatimin e Rezolutës për të Drejtat e Fëmijëve. Në pikën e fundit të kësaj rezolute është caktuar që Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me komisionet e tjera, të përgatisë planin e veprimit për zbatimin e kësaj rezolute. Unë do të doja mendimin tuaj për fillimin e punës për këtë plan veprimi. Siç jeni në dijeni, unë kam marrë takim me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që mbulojnë të drejtat e fëmijëve për të shkëmbyer informacion lidhur me projektet që ato kanë në proces, shqetësimet e tyre lidhur me ndryshimet ligjore apo për reformat e tjera institucionale. Megjithatë, plani i veprimit është një plan që ne duhet ta përgatitim vetë, duke pasur parasysh kompetencat që ka Kuvendi i Shqipërisë, duke përdorur të gjitha mekanizmat e kontrollit parlamentar, por edhe nismat ligjore që ne mund të marrim në cilësinë e deputetit.

Unë do të doja që sot të shkëmbejmë mendimet shumë shkurt se si mund të fillojmë veprimet për përgatitjen e këtij plani veprimi, por edhe për të bërë një plan vjetor të veprimtarisë që mund të bëjë Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut.

Faleminderit!

**Arben Ristani** – Lidhur me planin e veprimit për rezolutën duhet t'i marrim me radhë gjërat, siç i kemi përcaktuar edhe në rezolutë, edhe sipas bisedës që u bë në takimin me shoqërinë civile. Ata ngritën disa probleme dhe ne i miratuam. Përpara kemi buxhetin dhe besoj se një pikë e rezolutës është që duhet të ndikojmë te buxheti, që qeveria të planifikonte fond të veçantë për këto probleme që diskutojmë. Pra, duhet të shikojmë buxhetin, që do të vijë këto ditë apo jo.

Së pari duhet të shohim nëse te buxheti është reflektuar rezoluta apo jo, pastaj të shikojmë pikat e tjera me radhë. Për sa i përket vizitës monitoruese, duhet të kemi një axhendë të plotë se ku do të shkojmë, kë do të takojmë, kë do të marrim me vete.

**Vasilika Hysi** – Te rezoluta janë katër shtylla: nismat ligjore, pra përmirësime të ligjit, nxitja e qeverisë për të bërë një buxhetim duke pasur parasysh interesat më të larta të fëmijëve, nxitja e reformës për shërbimin social shtetëror, instrumentet e kontrollit parlamentar. Pra, kemi lënë seanca dëgjimore, interpelanca, thirrjen e ministrave për seanca pyetje-përgjigje, monitorimet në vend. Gjithashtu kemi marrë përsipër të caktojmë grupin e deputetëve që janë miq të fëmijëve, janë deputetë burra ose gra të profesioneve të ndryshme dhe unë jam dakord me atë që thotë Arbeni se duhet ta fillojmë me pjesën e buxhetit, pra të nxitim qeverinë për buxhetin, por njëkohësisht të orientojmë edhe komisionet e tjera që, kur të trajtojnë pjesën e buxhetit, të kenë parasysh zërat ose shërbimet që janë në interes të fëmijëve.

Lidhur me monitorimet ose me seancat dëgjimore, unë kam një sugjerim, por mund ta gjujkojmë së bashku. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve në Gjenevë i ka lënë qeverisë shqiptare disa detyra dhe ne duhet të fillojmë me monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve, çka kërkon që të kemi një plan të detajuar veprimi lidhur me rekomandimet. Gjithashtu është kërkuar që ne të nxitim paketat ligjore që tashmë shoqëria civile ose aktorë të tjerë i kanë bërë si propozime. Një bashkëpunim i veçantë është me Avokatin e Popullit për të parë mundësinë e krijimit të Komisionerit për të Drejtat e Fëmijëve. Pra, ka disa veprimtari ose bashkëpunime që do të jenë me institucionet kushtetuese, të pavarura, disa të tjera që janë me shoqërinë civile dhe një kategori tjetër janë me institucionet, me qeverinë. A mund të bëjmë një ndarje të punës mes nesh, meqenëse jemi një Nënkomision i vogël?

**Kastriot Islami** - Si çdo komision tjetër, por edhe ky besoj duhet të mbështet në katër shtylla. Shtylla e parë duhet të jenë marrëdhëniet me qeverinë. Pra, ne duhet të kërkojmë nga ministri që mbulon parlamentin se çfarë komponentësh ka qeveria në ministri të ndryshme për këtë çështje dhe ata duhet të na japin informacion, sepse qeveria ka detyrime për zbatimin e kësaj konvente. Është Ministria e Jashtme që e monitoron nga pikëpamja e përgjithshme, por në ministri të veçanta mund ta monitorojnë, kështu që duhet të na japin informacion të vazhdueshëm. Pra, një nga pikat që ne duhet të kemi në programin tonë është informimi nga qeveria se çfarë

detyrash e mundësisht çfarë plani veprimi kanë ato, se edhe ato kanë planet e tyre të veprimit.

E dyta është që ne duhet të marrim nga shoqëria civile. Natyrisht, duhet të marrim nga ajo inputet dhe këtu mund të bëjmë një plan veprimi, disa takime që mund të kemi me shoqërinë civile, që të na thonë shqetësimet e tyre.

E treta është nisma që kemi ne vetë në parlament. Këtu do të shikojmë nismat që merr qeveria, se praktikisht mekanizmat për të marrë nisma janë relativisht jo shumë të fuqishme, por do të shfrytëzojmë edhe qeverinë, ose do të ngacmojmë qeverinë që për këtë punë çfarë po bëhet dhe nëse ajo e ka nismën, ne do ta presim.

E katërta është monitorimi që kemi ne, ose ndjekja e të gjitha këtyre problemeve. Kështu që programi, them unë, duhet të ketë katër shtylla kryesore. Ne duhet të bëjmë një draft, pak a shumë, pastaj e diskutojmë në një seancë dhe shtojmë gjëra. Se, po të marrim përsipër secili punë të ndryshme, është më vështirë të koordinohet puna e disa vetave. Pra, ju bëni një draft, mundësisht merrni më parë informacion nga qeveria. Ajo do të jetë inputi kryesor. Po të kenë edhe komisionet e tjera disa inpute, do të jetë akoma më mirë. Kurse monitorimin mund ta kemi edhe vetë. Mund të kemi një ose dy monitorime në muaj, jo më shumë se kaq.

**Ermonela Felaj** - Për të gjitha këto që u përmendën këtu, unë do të doja që ne ta zgjeronim fokusin e veprimit si Nënkomision parlamentar për të Drejtat e Njeriut, sepse sigurisht që të drejtat e njeriut nuk janë vetëm të drejtat e fëmijëve. E nisim prej aty, por kemi edhe kategori tjetër personash që kanë shumë nevojë që të merret një lloj evidence nga ky Nënkomision, meqenëse është hera e parë që krijohet një nënkomision i tillë. Pra, do të doja që të paktën shoqatat që trajtojnë grupe të ndryshme personash për sa i përket të drejtave të tyre dhe natyrisht ato që janë më të spikatura në veprimtarinë e tyre ne në vijimësi t'i ftonim dhe të merrnim – me shumë të drejtë e tha edhe zoti Islami – problematikat e tyre, në mënyrë që të dimë edhe ne ku të punojmë, çfarë të kërkojmë dhe si mund t'i ndihmojmë.

Besoj se nuk kemi nevojë të bëjmë shumë ndarje të punëve midis nesh, sepse pak jemi, kështu që secili nga ne besoj se do ta ketë vullnetin për të marrë përsipër dhe për të kryer punë të ndryshme që do të marrë përsipër ky Nënkomision.

Faleminderit!

**Kastriot Islami** – Ndoshta një komponent i rëndësishëm është marrëdhënia me përfaqësuesit tanë në Këshillin e Europës. Këshilli i Europës në fokus të veçantë ka të gjitha të drejtat e njeriut, kështu që ne do të kërkonim (ne mund të kërkojmë

edhe vetë në internet) nga kryetarja ose nga delegacioni që gjithçka që lidhet me të drejtat e njeriut të na e vëre në dispozicion, aq më tepër kur bëhet fjalë për detyrime ku Shqipëria si anëtare ka edhe ajo detyrime më konkrete. Edhe ky është një komponent i rëndësishëm dhe ndoshta duhet parë në raportin e monitorimit, në qoftë se ka ndonjë detyrë që lidhet me të drejtat e njeriut dhe me këtë lidhet edhe heqja e monitorimit të Shqipërisë.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Islami, që sollët në vëmendje Këshillin e Europës!

Unë do të doja t'ju informoja se në muajin shtator 2014 Shqipëria do të monitorohet nga ECRI. Kam menduar dhe sugjeroj që rekomandimet e ECRI-t në bashkëpunim me sekretariatit, pra unë dhe Moza, ta bëjmë gati, sepse një pjesë e rekomandimeve lidhen me Kuvendin e Shqipërisë dhe konkretisht lidhen drejtpërdrejt edhe me Komisionin e Ligjeve dhe me Nënkomisionin e të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu ne kemi edhe *advisering committee* për çështjet e minoriteteve, është Komiteti për Parandalimin e Torturës, që ka lënë rekomandime, një pjesë e të cilave lidhen me veprimtarinë e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut. Bashkohem edhe me shqetësimin dhe me sugjerimet që ngriti zonja Felaj që ta nisim me Rezolutën për të Drejtat e Fëmijëve, që të fillojmë të vëmë në veprim planin e veprimit. Ndërkohë unë së bashku me sekretariatit e Nënkomisionit do të nxjerrim të gjitha detyrimet që ka Shqipëria në raport me Këshillin e Europës për vitin 2014, cilat janë vizitat monitoruese, cilat janë detyrimet që ne kemi në kuadër të çdo misioni monitorues.

Së treti, për të përmbledhur edhe ato çfarë thatë ju, një listë të të gjitha organizatave që operojnë në fushat kryesore të të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, zoti Islami, do të doja që të na ndihmonit në lidhje me ato detyrime që ka lënë Këshilli i Europës në kuadër të monitorimit të Shqipërisë. Cili është roli ynë si Nënkomision për të kontribuar që Shqipëria të dalë nga harta e monitorimit? Unë sugjeroj që disa nga mbledhjet t'i kemi të përbashkëta me komisionet e tjera, me qëllim që të prodhojmë sa më shumë sinergji.

Atëherë, a biem dakord që të bëjmë një plan pune? A mendoni që plani i punës të jetë një plan mujor, tremujor, vjetor, sepse për nënkomisionet e tjera planet janë trejavore, ndërsa Nënkomisioni ynë është disi i veçantë. Tremujore? Në rregull. Atëherë bëjmë një projektpropozim për një plan tremujor, ku pjesë e veçantë do të jetë plani i veprimit për rezolutën e të miturve, që do t'u kalojë edhe komisioneve të tjera për miratim.

Kush do të angazohet përveç meje? Me Arbenin dhe Ermonelën? Dakord. Do të komunikojmë me *imeil* për të diskutuar dhe në mbledhjen e javës së ardhshme do të diskutojmë edhe gjetjet e monitorimit të sotëm, por edhe do të kemi një ide për planin e veprimit.

Faleminderit!

Mbledhje tjetër do të njoftohet nëpërmjet sekretarisë.

**MBLEDHJA MBYLLET**